



REPUBLIKAE SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 5122/1 prot.

Himarë, më 07.07 2025

PROJEKT-VENDIM
Nr. 33, Datë 07.07.2025

PËR

**“PËR MIRATIMIN E KAHUT TË LËVIZJES, ORARIT TË LËVIZJES DHE
KUFIZIMIT TË QARKULLIMIT NË DISA AKSE TË BRENDSHME SË MJETEVE
AUTOMOBILISTIKE NË QYTETIN E HIMARËS”**

Bazuar në ligjin nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin nr. 8378/1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i përditësuar datë 16/03/2023), ligjin nr. 89/2022 “Për policinë bashkiake”, VKM-në nr. 153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës Së Shqipërisë” (përditësuar me VKM nr. 322, datë 29/05/2024); me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë:

VENDOSI

1. Miratimin e kahut të lëvizjes, orarit të lëvizjes dhe kufizimit të qarkullimit në disa akse të brendshme të mjeteve automobilistike në qytetin e Himarës sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Bashkia Himarë përmes sektorëve teknikë dhe urbanistikës, të vendosë sinjalistikën e nevojshme rrugore.
3. Ngarkohet Bashkia Himarë përmes Policisë Bashkiake të kontrollojë zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Bashkia Himarë përmes njësive të komunikimit të bashkisë të informojnë publikun për ndryshimet përmes mjeteve zyrtare dhe çdo forme të komunikimit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata dhe Kryetari i Bashkisë Himarë.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar në Ligjin nr. 139/2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 55 pika 6.

KRYETARI
Vangjel Tavo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 5122/2 prot.

Himarë, më 07.07 . 2025

RELACION:

MBI PROJEKT VENDIMIN PËR “PËR MIRATIMIN E KAHUT TË LËVIZJES, ORARIT TË LËVIZJES DHE KUFIZIMIT TË QARKULLIMIT NË DISA AKSE TË BRENDSHME SË MJETEVE AUTOMOBILISTIKE NË QYTETIN E HIMARËS”.

Të nderuar Këshilltarë!

Projekt Vendimi që po ju paraqesim vjen pasi kemi marrë dhe shqyrtuar një problematikën e qarkullimit të mjeteve motorike në qytetin e Himarës. Në kuadër të përgatitjeve për sezonin turistik veror 2025 dhe në funksion të përmirësimit të qarkullimit, sigurisë rrugore dhe orientimit të turistëve në territorin e qytetit të Himarës, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Policisë Bashkiake dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Himarë, ka hartuar një plan të përrregullimin e lëvizjes së mjeteve në akset kryesore urbane.

1. BAZA LIGJORE:

Ky projekt-vendim mbështetet në kuadrin ligjor në fuqi:

- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i përditësuar), nenet 23 e në vijim;
- Ligji nr. 8378/1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i përditësuar datë 16/03/2023)
- Ligji nr. 89/2022 “Për policinë bashkiake”
- VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës Së Shqipërisë” (përditësuar me VKM nr. 322, datë 29/05/2024).

❖ ARSYETIMI TEKNIK DHE LIGJOR I KËTIJ PROPOZIMI:

❖ Qëllimi i ndërhyrjes

- Reduktimi i trafikut të rënduar në orët e pikut
- Lehtësimi i aksesit të këmbësorëve dhe turistëve në zonat turistike dhe plazhe
- Organizimi më efikas i parkimeve dhe aksesit në qendër dhe plazh
- Sigurimi i korridoreve të emergjencës dhe shërbimeve të transportit public
- Reduktimin e ndotjes së ambjentit dhe asaj akustike në qendrat urbane dhe kulturore.

❖ Arsytimi ligjor

Përsa i përket propozimit që sjellim para jush po ju referojmë në mënyrë të përmblodhur dhe bazueshmërinë ligjore;

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i përditësuar)

- Neni 23 dhe në vijim parashikon se njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë) kanë kompetencë për të:
 - organizuar transportin publik vendor,
 - ndërtuar, mirëmbajtur dhe administruar rrugët vendore dhe urbane,
 - rregulluar dhe sinjalizuar qarkullimin brenda territorit të tyre administrativ.

Bazuar në ligjin nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”

- Ky ligj përforcon rolin e policisë bashkiake në:
 - zbatimin e akteve të Këshillit Bashkiak në fushën e qarkullimit rrugor,
 - monitorimin dhe garantimin e rendit në rrugët e qytetit,
 - marrjen e masave ndaj mjeteve që shkelin rregullat vendore për qarkullimin.

Bazuar Ligji nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, (i përditësuar me ndryshimet, më 16.03.2023)

Neni 6, pika 4 i jep kompetencë bashkive për të vendosur kufizime të përkohshme ose të përhershme për kategori të caktuara mjeteve, përcaktuar orare dhe kahje të lëvizjes për shkak të fluksit, mjedisit apo sigurisë.

❖ **Arsyetimi teknik për zonat e përfshira në ndryshim**

- **Rruga Qendrore Spile–Qendra Himarë–Plazh Potam**
- **Segmenti përreth Shëtitores Bregdetare**
- **Rrugët dytësore lidhëse me rrugën nacionale SH8**

3. Masat konkrete të propozuara

Masa e propozuar	Përshkrimi	Zbatimi
1. Rrugë njëkalimshe	Kthimi i disa akseve dytësore në rrugë me një drejtim për të shmangur ndërlikimet e trafikut	Gjatë gjithë sezonit turistik (1 korrik – 15 shtator)
Ruga Jorgji Bollano 0420032	Segmenti / rreth rrotullimi i unazës deri tek Big Market	Gjatë gjithë sezonit turistik (1 korrik – 15 shtator)
Ruga Jorgji Bollano 0420032 Ruga Vangjel ZOTO 0420098	Segmenti Big Market deri tek rreth rrotullimi në Rrugën Vangjel Zoto	Gjatë gjithë sezonit turistik (1 korrik – 15 shtator)
Ruga Xhorxh Tenet 04200101	Segmenti Big Market deri tek kryqezimi I Policise	Gjatë gjithë sezonit turistik (1 korrik – 15 shtator)
Ruga 25 Marsi 04200002	Kryqezimi I Bashkise deri tek Bar MANOLO	Gjatë gjithë sezonit turistik (1 korrik – 15 shtator)
Ruga 2 Dhjetori 04200001	Segmenti Bar Manolo deri tek Ura e Portit	Gjatë gjithë sezonit turistik (1 korrik – 15 shtator)
Ruga 2 Dhjetori 04200001	Segmenti Policia deri tek Ura e kryqezimit te Stadiumit.	Gjatë gjithë sezonit turistik (1 korrik – 15 shtator)

Masa e propozuar	Përshkrimi	Zbatimi
2. Rugë dykalimëshe		
Ruga 2 Dhjetori 04200001	Segmenti Porti deri tek Kryqëzimi Policisë.	Gjatë gjithë sezonit turistik (1 korrik – 15 shtator)
Ruga Niko Kutulla 04200060	Segmenti i Urës në Kryqëzimin e Stadiumit deri tek Stadiumi	Gjatë gjithë sezonit turistik (1 korrik – 15 shtator)
Ruga Vangjel Zoto 04200098	Segmenti rreth rotullimi deri në aksesin e by Pass- it	Gjatë gjithë sezonit turistik (1 korrik – 15 shtator)
3. Zona pedonale	Ndalim i qarkullimit të mjeteve në segmentin e shëtitorës (nga ora 19:00 deri në 00:00)	Me sinjalistikë të përkohshme
4. Kufizim orari për hyrje mjeteve për furnizimet.	Lejohet vetëm 05:00–10:00	E vlefshme për furnizime
5. Drejtim dhe sinjalistikë turistike	Vendosje tabelash me drejtime për “Qendër”, “Plazh”, “Parking” dhe pikat turistike	Brenda datës 10 korrik
6. Riorganizim parkimesh	Parkime të përkohshme të orientuara dhe të sinjalizuara në rrugët dytësore	Me bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe NSHP-në.

4. Përfitimet e parashikuara

- Reduktim i trafikut dhe kaosit rrugor
- Përmirësim i përvojës turistike dhe qarkullimit të qytetarëve
- Siguri më e lartë për këmbësorët dhe biçiklistët
- Menaxhim më i mirë i fluksit të automjeteve
- Reduktim i ndotjes mjedisore dhe asaj akustike.

Këshilli Bashkiak i Himarës është i ftuar të shqyrtojë dhe të aprovojë këtë projekt vendim për të mundësuar implementimin e projekteve të mëdha infrastrukturore rrugore që do të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe social të zonës. Ky rregullim është në interes të përgjithshëm publik dhe synon të përmirësojë qarkullimin, të rrisë sigurinë rrugore, të mbrojë mjedisin dhe cilësinë e jetës për banorët dhe vizitorët në qytetin e Himarës.

KRYETAR
Vangjel Tavo



NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI
Pervin Gjikuria







